

- Dialektet dhe gjuha standarde në vendin e emigracionit: çfarë dinë N për to; kur përdoret, cili variant; cili është prestigji i dialektit këtu?
- Diskutim: Marrëdhënia ime emocionale me dialektin dhe gjuhën standarde në gjuhën e parë dhe të dytë; Vlerësimi im për përdorimin praktik të dialektit dhe të gjuhës standarde.

3.6 Korrespondenca për çështjet ndërkulturore

Qëllimi

Pyetjet që lidhen me jetën në, me dhe në mes të kulturave janë veçanërisht aktuale për nxënësit e MGJP. Qëllimi i projektit «korrespondencë» është për t'i diskutuar këto çështje me njerëz nga kontekste të tjera dhe nëpërmjet kësaj për t'i zgjeruar pikëpamjet personale. Në të njëjtën kohë, projekti ndihmon për kompetencën në të shkruar dhe për kompetencën për mediat.

kl. 5–9

45 min.



Rrjedha:

- Në bazë të një teme aktuale në kuadër të temës «Bashkëjetesa ndërkulturore» M i nxit N për të marrë pikëpamjet e njerëzve nga kontekstet e tjera dhe për t'u ballafaquar me to. Kjo duhet të ndodhë në formën e një korrespondence elektronike (e-mail, ndoshta SMS). Tema/çështje të mundshme: Përvoja personale me ksenofobinë të ne – pozita e «të huajve» në sistemin politik – pozita e MGJP në sistemin arsimor – pozita dhe prestigji i pakicave të tilla si p.sh.romët – diskutim në lidhje me debatin aktual politik.



- Me klasën zgjidhet një temë dhe diskutohen partnerët/et korrespondentë të mundshëm dhe kontekstet. Shembuj të korrespondencës me klasët: Një klasë e shkollës nga vendi i prejardhjes – një klasë e MGJP në një komunë tjetër të vendit mikpritës – një klasë MGJP në një vend tjetër të emigracionit – një klasë e MGJP nga një grup tjetër gjuhësor. (Tek vendosja e kontakteve përkatëse ndoshta mund të ndihmojë Ministria e Arsimit e vendit të prejardhjes.) Për korrespondenca individuale: të afërmit, miqtë, të njohurit brenda grupit ose nga grupet e tjera gjuhësore. Është emocionuese kur e njëjta çështje u shtrohet adresuesve/eve në kontekste të ndryshme. Sigurisht, mund t'u shkruhet edhe politikanëve/eve ose autoriteteve dhe të lutet që të japin pozicionimin e tyre.

- Do të ketë dakordim për kushtet paraprake për korrespondencën (p.sh. një numër çështjesh të përbashkëta), në mënyrë që rezultatet të jenë të krahasueshme.
- Në qoftë se kanë ardhur përgjigje të mjaftueshme, ato do të vlerësohen, grupohen, paraqiten (p.sh. në një poster) dhe diskutohen.

3.7 Përdorimi i gjuhës: i ndryshëm sipas kontekstit!

Qëllimi

Kompetenca në të vepruar dhe në komunikim parakupton që njeriu të sillet në atë mënyrë që, si në aspektin gjuhësor, por edhe me gjeste, mimikë, largësia gjatë të folurit, t'u përshtatet situatave përkatëse ose gërshetimeve sociale. Rregullat përkatëse janë kryesisht të pashkruara dhe kulturalisht të veçanta. Duke menduar rreth tyre dhe duke eksperimentuar me to, forcohen kompetencat sociale dhe komunikuese.

kl. 3–9

20–45 min.



Rrjedha:

- Hyrjet e mundshme në temë:
 - Një pyetje nxitëse (p.sh.: Të drejtuarit me «ju» dhe «ti» në gjuhën tonë dhe në gjuhën e vendit ku jetojmë tani?).
 - Një episod nga një keqkuptim komunikues (ngatërrimi i ju/ti/; distancë shumë e afërt me personin të cilit i drejtohesh, me zë të lartë, mënyrë tepër formale e përshëndetjes).
 - Një fillim i mirë mund të bëhet edhe kur M qëllimisht nuk e zbaton një rregull të pashkruar të komunikimit (përdorim i gjuhës tepër formal ose i çrregullt ndaj një nxënëseje; zë tepër i ulët ose tepër i lartë ...).
- Diskutim mbi çështjet e shtruar; Formimi i vetëdijes për normat e pashkruara, të cilat (përveç kuptimit gramatikor) duhet të respektohen për funksionimin e komunikimit.
- Eksperimente skenike me përdorimin e veçantë grupor të gjuhës dhe të elementeve jogjuhësore (kontakti trupor, volumi, gjestet, largësia e folësit etj): Çfarë «përshtatet» në komunikimin me shokët/shoqet – me autoritetet – me gjyshërit – me vëllezërit e motrat etj.? Çfarë do të ishte jo me vend; pse? Të mendohet edhe për përdorimin e dialektit dhe të gjuhës standarde.
- Krahasimi i normave në lidhje me ju/ti, vëllimi, distanca gjatë të folurit, kontakti fizik, dhënia/puthja e dorës gjatë përshëndetjes etj. në kulturën e prejardhjes dhe në vendin e emigracionit. Ku ka dallime të rëndësishme? Çfarë do t'i këshillonit patjetër dikujt që vjen i ri në një vend? (Ndoshta të shkruhet një check-listë.)
- Gjestet: Cilat gjeste në kulturën tonë të prejardhjes janë të rëndomta (ose tabu), e cilat në vendin ku jetojmë tani; cilat janë «ndërkombëtare»?